

16 qershor 2018: Demonstratë për të drejtën dinjitoze të Azilit

Për një shoqëri të angazhuar dhe të hapur

Me 16 qershor mbi 60 organizata thirrin demonstratën mbi regjionale “Mes nesh s’ka kufij”. Ato ftojnë të gjithë të manifestojnë kundër racizmit dhe kundër tendencave represive e armiqësore karshi të huajve që nga rrafshet ndër njerëzore deri tek ato ndërkombëtare!

Luftërat e vjetra dhe të reja janë duke shkretuar edhe më tej regjione të panumërta të kësaj bote, dhuna dhe varfëria detyrojnë me miliona njerëz të arratisen. Kufijtë zhvendosen sa më larg që është e mundur dhe deti Mesdhe në varrezë masive. Në Zvicër, njerëzit janë të indinjuar për tregtinë me skllavë në Libi dhe njëkohësisht janë të kënaqur me numrin në rënie të kërkesave për azil.

Presioni në rritje ndaj refugjatëve

Presioni në njerëzit që janë në arrati po rritet. Qendrat federale edhe më shumë po përkeqësojnë marrëdhëniet mes popullatës dhe azilkërkuesve dhe shumë janë të shtyrë në izolim. Statusi i përkohshëm F mban me mijëra veta në pasiguri afatgjatë dhe pengon jetën e pavarur në Zvicër. Mocioni i iniciuar nga e djathta “Për një legjislacion koherent për personat pa letra” i cili është paralajmëruar për sesionin parlamentar të verës, synon tu heq të drejtën personave pa letra, si atë për sigurim shëndetësor dhe shkollim të fëmijëve të tyre. Në Kantonet, si Cyrihu apo Gjeneva, ku për ndihmën elementare përdoren strategji represive, për të detyruar njerëzit të largohen nga vendi.

Zvicra dëbon për në vendet e BE-së

Zvicra feston në dhjetor 10 vite të anëtarësisë në Dublin dhe në këtë 10 vjeçar ajo ka ndërmarrë 30'000 kthime në shtetet e BE-së. Edhe pse një nga vendet më të pasura të botës, Zvicra dërgon njerëzit që janë në arrati më me dëshirë në vendet, të cilat ka kohë janë të sfiduara me këto probleme.

Me vdekjen e Mike, një person pa letra dhe anëtar i Kolektivit Jean Dutoit në Lozanë, në muajin mars është personi i 5-të jo i bardhë, i cili brenda 18 muajsh vdes në duart e policisë. Ky rast është kulmi i pikëllimit.

Solidarité sans frontières

16 qershor, në ora 14, vendtakimi në “Schützenmatte”, Bernë. Më shumë informata në: www.sosf.ch.